

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Beshir Islami kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Jelena Krivokapić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

M. V., me vendbanim në Beograd,

Kundër:

S. M. Prishtinë,
Palë përgjegjëse,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013, të datës 27 Nëntor 2013, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA...), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 12 Qershor 2019, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga M. V., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013, të datës 27 Nëntor 2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA...**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013, i datës 27 Nëntor 2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA...**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datë 16 Maj 2007, M. V., (në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), në cilësinë e bartësit të pretenduar të drejtës pronësore, me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore me 1/1, pjesë ideale dhe ri-posedimin e banesës tri dhomëshe në sipërfaqe prej **80.74m²**, e cila ndodhet në lagjën, , (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). I njëjti deklaron se posedimin e banesës e ka humbur si pasojë e konfliktit të vitit 1998/99, si datë të humbjes e cek datën 16.06.1999, po ashtu thekson se e banesa është e uzurpuar dhe është duke u shfrytëzuar në mënyrë të pa ligjshme.

2. Në mbështetje të kërkesës së tij në AKP , ka dorëzuar *inter alija* dokumentet vijuese;
- Kontratën mbi shitblerjen e banesës lëndore nr. ..., të dt. 18.04.1999, të lidhur në mes tij si blerës dhe shitësit Elektroekonomia e Serbisë(Ndërmarrja Publike për Prodhimin Përpunimin dhe Bartjen e Thëngjillit, Mihja Sipërfaqësore Obiliq-Dobro Selo), (tutje; KEK),me të cilën dëshmon blerjen e banesës lëndore.
 - Kontratën për shfrytëzimin e banesës për mes Qiras, nr. ..., të dt. 18.03.1999,të lidhur në mes të palës ankuese dhe Ndërmarrjes Elektroekonomia e Serbisë-ndërmarrjes publike të mihjes sipërfaqësore të thëngjillit Dobro Selo .
 - Vërtetimin nr...., të dt.18.03.1999, me të cilin vërtetohet se pala ankuese e ka paguar në tërësi çmimin blerës të banesës lëndore.
 - Kontratën e shitblerjes nr...., dt.13.07.1989, me të cilin KEK e ka blerë banesën lëndore nga Kompania GRP-Novogradnja Vranje, OOUR ,... Prishtina.
 - Vendimin nr....,dt. 01.12.1990 me të cilin KEK-u, ja ndan banesën lëndore pronarit të më parshëm J. P..
 - Kontratën për shfrytëzimin e banesës nr. ..., dt.20.03.1991, e lidhur në mes të ish pronarit të banesës P. J. dhe NPB-së.
 - Kontratën e shitblerjes ,nr. ...,dt. 11.02.1993, me të cilën pronari i më parëm i banesës P. J., e ka blerë banesën nga KEK.
 - Aktvendimin nr...,dt. 26.07.1993, në bazë të cilit në kadastër banesa e blerë regjistrohet në emër të P. J.,(azhurimi i bërë sipas kontratës nr...).
 - Kontratën e shitblerjes nr. ..., dt. 28.01.1999, me të cilën pronari i më parëm ja shet banesën e kërkuar, ndërmarrjes “...” ...-Obiliq.
 - Deklaratën e vërtetuar nr.... , dt.30.09.2005, me të cilën Z. J. ka deklaruar se me datë 28.01.1999,ja ka shitur banesën e kërkuar me autorizimin e bashkëshortit të saj, pronarit të më parshëm ndërmarrjes së Mihjes Sipërfaqësore Dobro Sellë,(KEK)
 - Deklaratat e dy dëshmitarëve të vërtetuara, të cilët dëshmojnë se pala ankuese a ka pas në posedim dhe shfrytëzim banesën lëndore.
3. Me datë 04 janar 2008 AKP-ja, ka bërë identifikimin e pronës së kërkuar. Prona rezultoi të jetë apartament banimi e uzurpuar nga B. M. e cila ishte prezentë në kohën e vizitës. Bashkëshorti i saj S. M. me datë 21 janar 2008, paraqitet në AKP i cili deklaron se pretendon të drejtë ligjore në banesën lëndore, e nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë dhe paraqet përgjigje me shkrim lidhur me pronën kontestuese duke deklaruar se, ai është pronar legjitim e jo pala ankuese i cili asnjëherë nuk ka qen pronarë i kësaj banese, se M. V. kishte paraqitur më herët edhe kërkesë në Komisionin për çështje pronësore banesore(KÇPB), i cili organ me vendimet e tij të shkallës së parë dhe të dytë e ka refuzuar kërkesën dhe ankesën e palës ankuese ndërsa ja ka njohur këtij të drejtën e posedimit. Po ashtu deklaron se kjo banesë më parë ka qen e P. J., të cilit KEK, ja kishte ndarë në vitin 1989, të njëjtën e kishte privatizuar në vitin 1993, ndërsa ky e ka blerë nga ai në vitin 1998

- dhe është në posedim të saj, si dëshmi e paraqet kontratën jo formale të lidhur në mes tyre të dt. 10.07.1998.
4. Gjatë përpunimit të kërkesës së palës ankuese nga dokumentet e ofruara nga palët dhe të siguruara nga sekretaria e AKP-së, është vërtetuar se prona e kërkuar ishte blerë prej Elektro Ekonomisë nga ndërmarrja GRO ... Vranje, dhe kjo banesë i ishte ndarë pronarit të më parëm P. J., sipas kontratës për shfrytëzim nr. ..., i cili e kishte privatizuar këtë pronë ,këto dokumente janë verifikuar pozitivisht.
 5. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit nga AKP, të datës 03 Tetor 2013, dokumentet e bashkangjitura nga pala ankuese lidhur me pronën e kërkuar si, Kontrata për shfrytëzimin e banesës për mes Qiras, nr. ..., të dt. 18.03.1999, të lidhur në mes të palës ankuese dhe Ndërmarrjes Elektroekonomia e Serbisë-ndërmarrjes publike të mihjes sipërfaqësore të thëngjillit Dobro Selo, dhe Kontrata mbi shitblerjen e banesës, të lidhur në mes tij si blerës dhe shitësit Elektroekonomia e Serbisë,(ndërmarrjes publike për prodhimin përpunimin dhe bartjen e thëngjillit Mihjes sipërfaqësore Obiliq-Dobro Selo), me të cilën e ka blerë banesën lindore, nuk janë gjetur në institucionet kompetente në Elektro ekonominë e Kosovës,(KEK) dhe as në gjykatën kompetente, prandaj verifikimi i këtyre dokumenteve mbështetëse kishte rezultuar negativ. Pala ankuese po ashtu kishte dështuar të dëshmoj se ka qenë në posedim të kësaj prone.
 6. AKP-ja *ex officio* ka vërtetuar se, prona e kërkuar ka qenë objekt shqyrtimi nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banësore,(KKPB) i themeluar me UNMIK/REG/1999/23, dhe UNMIK/REG/2000/60, sipas kërkesës së palës ankuese M. V., të kategorisë “C”, prona e njëjtë është proceduar si pronë banësore. Kërkesa e tij është evidentuar me nr. DS300197, e cila është kontestuar nga pala përgjegjëse S. M. KKPB-ja, me Vendimin e saj nr. HPCC/D/204/2005/C, të datës 18 Qershor 2005, e kishte refuzuar kërkesën e palës ankuese. Arsyetimi i vendimit grupor i cili referohen në veçanti kërkesës së palës ankuese, sqaron se, ushtruesi i kërkesës ka dështuar të tregojë ndonjë provë dokumentuese që ai e kishte pas në posedim ndonjëherë pronën e kërkuar, apo ndonjë dëshmi për të drejtën pronësore të verifikuar , që i jep të drejtën e marrjes në posedim të pronës së kërkuar. Po ashtu Kërkesa e tij për rishqyrtimin e vendimit të shkallë së parë ishte refuzuar nga KKPB-ja me vendimin final, HPCC/REC/81/2006, të dt. 11.12.2006. Në arsyetimin e vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar zbatohet në veçanti për kërkesën, thuhet se paraqitësi i kërkesës të kategorisë “C”, me ankesë nuk ka paraqitur asnjë dëshmi të re për veç dëshmimeve të njëjta të kërkesës të cilat janë trajtuar në Vendimin grupor në procedurë të shkallës së parë përkatëse.
 7. Edhe pse kërkesa e paraqitur në AKP ishte për pronën e njëjtë, ky organ këtë çështje nuk e trajtoi si çështje të gjykuar nga HPCC, sepse kërkesa në HPD ishte kërkesë e kategorisë “C”, dhe kishte të bënte ekskluzivisht me të drejtën për posedim. AKP po ashtu gjen se mënyra e vendosjes në HPCC, dhe dëshmitë e paraqitura materiale me kërkesë nga pala ankuese janë të njëjta, të cilat nuk kanë mundur të verifikohen pozitivisht si dëshmi valide ekzistuese.

8. Me datë 27 nëntor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK), me vendimin e vet KPCC/D/R/263/2013, ka vendosur që kërkesa e palës kërkuese të refuzohet. Në paragrafin 32 , të vendimit grupor, i cili zbatohet në veçanti për kërkesën thuhet se, dokumentet të cilat i ka dorëzuar paraqitësi i kërkesës në cilësinë mbajtësit të pretenduar të drejtës pronësore, nuk janë verifikuar pozitivisht si origjinale nga Sekretaria Ekzekutive, po ashtu sekretaria as *ex officio*, nuk ka arrit të siguroj ndonjë dëshmi, në bazë të cilave do të verifikohej se bartësi i të drejtë pronësore gëzon një të drejtë ligjore në pronën e kërkuar.
9. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar M. V. me datë 12 prill 2015. Me datë 04 Maj 2015, i njëjti ka ushtruar ankesë.
10. Pala përgjegjëse S. M. kopjen e ankesës së palës ankuese, e ka pranuar me datë 31 Mars 2015, nuk ka prova se ka paraqitur përgjigje në ankesën e palës ankuese.

Pretendimet e palës ankuese;

11. Pala ankuese Vendimin e ankimuar e konteston si jo ligjor dhe jo të drejtë për shkak të; cënimit thelbësor të dispozitave procedurale, aplikimit të gabuar të drejtës material dhe vërtetimit jo të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike me ndikim për të vendosur lidhur me kërkesën për vërtetimin e të drejtës në kthimin në posedim të pronës së kërkuar.
12. Tutje në ankesë ndër të tjera e përshkruan gjendjen sipas kërkesës së ushtruar në AKP dhe dokumeneteve të paraqitura në këtë organ dhe vlerëson se në bazë të tyre e ka dëshmuar të drejtën në pronën e kërkuar por KKPK nuk ja ka njohur këtë të drejtë, se të drejtën e tij pronësore e mbrojnë edhe KEDLNJ, ESPLJP, aktet e tjera ndrëkombëtare dhe Kushtetua e Kosovës ndërsa dëshmit e ofruara nga pala përgjegjëse, se gjoja e ka blerë banesën nga P.J., i konsideon se janë të falsifikuara etj.
13. Në fund kërkon që Gjykata Supreme pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës, fakteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala ankuese të bie vendim me të cilin anulohet vendimi i ankimuar dhe lënda ti kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje AKP-së, ose të bie vendim me të cilin aprovohet kërkesa e tij për kthimin e posedimit në palujtshmërin kontestuese-banesën.

Pranueshmëria e ankesës

14. Ankesa e palës ankuese është e afatshme dhe e pranueshme, është paraqitur brenda afatit prej 30 ditë ashtu si parashihet në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79, që përcakton se ankesa kundër vendimit të KPCC, mund

të paraqitet brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit. Po ashtu ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur nga pronari i pretenduar i pronës së kërkuar.

Meritat e Ankesës;

Arsyetimi ligjor

15. Gjykata Supreme pas shqyrtimit të vendimit të ankimuar sipas pretendimeve në ankesë dhe sipas detyrës zyrtare, si dhe shkresave të tjera të lëndës në kuptim të nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjen se ankesa është e pa bazuar.
16. Nuk është kontestuese se pala ankuese, për pronën e njëjtë paraprakisht më herët i ishte drejtuar Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore,(KKPB-së), ku kishte kërkuar ri-posedimin e banesës së njëjtë, e cila pretendohet se është humbur gjatë konfliktit të vitit 1998/99. KKPB-ja me vendimin HPCC/D/204/2005/C, të datës 18 Qershor 2005, e ka refuzuar kërkesën e tij DS300197, sepse nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar se e ka pasur ndonjëherë posedimin e pronës-banesës së kërkuar, apo se ka poseduar dëshmi mbi posedimin e saj para datës 24 Mars 1999. Ndërsa me Vendimin, HPCC/REC//81/2006, të dt. 11.12.2006, kërkesa e tij për rishqyrtimin e Vendimit të shkallës së parë është refuzuar, me që pala kërkuese nuk kishte paraqitur asnjë dëshmi të re për veç atyre të paraqitura në shkallën e parë.
17. Megjithatë, për të dëshmuar të drejtën e tij pala ankuese kishte paraqitur kërkesë në AKP, duke u bazuar në dëshmitë e cekura bashkangjitur kërkesës të cilat ishin prezantuar edhe më parë në KKPB,(HPD). KKPK bazuar në dëshmitë materiale të cilat i ka ofruar pala ankuese, të cekura si në paragrafin dy(2.) të këtij aktgjykimi, të cilat nuk është arrit të verifikohen pozitivisht si ekzistuese dhe valide në organet kompetente, e po ashtu as *ex officio*, nuk ishte arrit të sigurohej asnjë provë në mbështetje të kërkesës së palës ankuese, nga këto shkaqe kërkesa e tij është refuzuar si jo e bazuar, në kuptim të nenit 11.4 b) dhe 3.1 të Rreg. së UNMIK 2006/50 e plotësuar me Ligin 03/L-079.
18. Sipas nenit 3.1, të Ligjit nr.03/L-07, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën e pronësisë mbi një pronë të pa luajtshme private të kërkuar, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht ti ushtroj ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërliken drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë , ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.
19. Bazuar në dispozitën e cekur si më lartë, e duke i shqyrtuar pretendimet ankimore sipas bazave ankimore të cekura në ankesë të palës ankuese gjykata supreme duhet të sqaroj faktet , nëse pala ankuese para apo gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, ka pasur ndonjë të drejtë ligjore pronësie apo të drejtë të shfrytëzimit mbi banesën e kërkuar.

20. Pala ankuese të drejtën e tij në banesën e kërkuar sipas pretendimeve në ankesë e bazon në faktet se pronën e kërkuar e ka pas në posedim para konfliktit të ndodhur në Kosovë në të cilën ka pasur të drejtë pronësore, në bazë të vendimeve të cekura të vitit 1999, se banesën e njëjtë e ka blerë sipas kontratës mbi shitblerje të dt. 01.02.1999, dhe pasi ka paguar çmimin blerës ka hyrë në posedim të saj në bazë të kontratës për shfrytëzim të datës 18.03.1999, po ashtu deklaron se këtë e ka dëshmuar në AKP edhe me dokumentet e tjera të bashkangjitura kërkesës, etj ”, kolegji i Gjykatës Supreme, këto pretendime i vlerëson se nuk janë të bazuara, andaj jep arsyetimin si vijon:
21. Dokumentet e cekuar si më lartë të palës ankuese të paraqitura edhe në AKP, është fakt se asnjëri prej këtyre dokumenteve referente nuk kishin mundur të verifikoheshin nga sekretaria e AKP-së si ekzistuese, po ashtu me asnjë provë nuk është provuar se pala ankuese e ka pas në shfrytëzim ligjor apo pronësi këtë banesë para apo gjatë periudhës së viteve 1998/99. Për më tepër as në procedurë ankimore në gjykatën supreme nuk arrin të paraqes dokumentacion tjetër valid apo prova të reja, nga ato që ishin paraqitur në AKP e të cilat ishin verifikuar negativisht.
22. Andaj gjykata supreme gjen se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë, të bazuar në një procedurë të plotë dhe të saktë, dhe nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim të gabuar ose jo të plotë të fakteve, kur vërteton se pala ankuese nuk ka dëshmuar të drejtë pronësore apo ndonjë të drejtë tjetër shfrytëzimi në banesën e kërkuar gjatë konfliktit të armatosur . Në ankesë pala ankuese i përsërit pretendimet e njëjta të bëra pran KKPK-së, andaj gjykata supreme gjen se ankesa është e pa bazuar ,ndërsa Vendimi i KKPK-së vërtetohet si i drejtë dhe ligjor, sepse pala ankuese ka dështuar të paraqes dokumente valide për të dëshmuar të drejtën në pronën e kërkuar.
23. Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj lënde edhe *ex officio*, gjen se, Vendimi individual që i referohet kërkesës së palës ankuese me numër KPA33695, ishte i përfshirë me gabim gjuhësor por që ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e qështjes së vendosur. Në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se, “*kërkesa hedhet*”, kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim dhe në vendimin individual në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se, “*kërkesa refuzohet*”.
24. Sipas dispozitave materiale përcaktohet se, në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, “*Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet versionit në gjuhën angleze të*

dokumentit apo vendimit karshi verzionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojnë dhe do të përdoret’.

25. Prandaj me që vendimi burimor grupor në të trija gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe, figuron se “refuzohet kërkesa”, nuk është me ndikim gabimi gjuhësor në vendimin individual në gjuhë serbe, sepse duhet të jetë kërkesa refuzohet , e jo kërkesa hedhet, sepse interpretimi dhe verzioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjiner dhe si i tillë përdoret.
26. Nga theksimet si më lartë, e në pajtim me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

27. Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-022-2016, me datë 12 Qershor 2019

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Beshir Islami